(4) Për shërbimet shëndetësore që u jepen të huajve arkëtohet sipas listës së çmimeve të miratuar nga drejtori i KUTSK-së, për të cilën pëlqim jep ministri i Shëndetësisë.

Veprimtari plotësuese

Neni 17

(1) Punëtorët shëndetësorë-specialist, përkatësisht bashkëpunëtorët shëndetësorë të punësuar në KUTSK mund të kryejnë veprimtari plotësuese, përkatësisht të japin shërbime shëndetësore si punë plotësuese, pas orarit të punës, në pajtim me licencën për punë në KUTSK ose në institucionin tjetër shëndetësor i cili është i regjistruar për veprimtari të njëjtë ose të ngjashme.

(2) Veprimtaria plotësuese nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet nën kushte të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

PJESA E KATËRTË

IV. PUNËTORËT SHËNDETËSORË DHE BASHKËPUNËTORËT SHËNDETËSORË TË PUNËSUAR NË INSTITUCIONIN SHËNDETËSOR PUBLIK KLINIKA UNIVERSITARE PËR TRANSPLANTIM TË ORGANEVE DHE INDEVE DHE SËMUNDJE KIRURGJIKE

Rroga dhe shtesa për kryerjen e shërbimeve të ndërlikuara shëndetësore

Neni 18

(1) Të punësuarit në KUTSK janë punëtorë shëndetësorë dhe bashkëpunëtorë shëndetësorë specialistë me përvojë dhe të afirmuar për transplantim, kirurgji, mjekësi interne, anesteziologji dhe radiologji.

(2) Rrogat e të punësuarve janë përcaktuar me marrëveshje të veçantë kolektive të nënshkruar ndërmjet drejtorit të KUTSK-së dhe sindikatës së të punësuarve në KUTSK.

(3) Ministri lidh marrëveshje të veçantë me të punësuarit e KUTSK-së për shtesë për kryerjen e shërbimeve të ndërlikuara shëndetësore që paguhet nga programi nga neni 4 paragrafi (2) i këtij ligji për financimin e transplantimit të organeve dhe indeve dhe sëmundjeve kirurgjike të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe nga burimet tjera.

Kushtet për kryerjen e veprimtarisë

Neni 19

(1) KUTSK-ja mund të kryejë veprimtari nëse në marrëdhënie pune ka së paku tre doktorë shkence të punësuar nga sfera e mjekësisë, nga të cilat së paku dy të zgjedhur në titullin profesorë të rregullt universitar në dy zgjedhje ose mësimdhënës në fakultetin e mjekësisë.

(2) KUTSK-ja mund të kryejë veprimtari dhe nëse mësuesit nga paragrafi (1) i këtij neni janë në marrëdhënie pune në klinikën universitare dhe në fakultetin e mjekësisë, në pajtim me rregullat nga sfera e marrëdhënieve të punës dhe marrëveshja për punësim.

Punësimi

Neni 20

(1) Procedura për punësim e punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë në KUTSK bëhet në pajtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

(2) Punësimi nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet përmes lidhjes së marrëveshjes në kohë të pacaktuar.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, në rast të pamundësisë nga zbatimi i procedurës për punësim në kohë të pacaktuar, e kur ekziston nevoja në KUTSK nga punëtorët shëndetësorë dhe/ose bashkëpunëtorët shëndetësorë, për kryerjen e papenguar të shërbimit publik të institucionit, të njëjtit mund të punësohen me marrëveshje për punësim në kohë të pacaktuar deri në pesë vjet.

(4) Për të punësuarit nga paragrafi (3) i këtij neni zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për mbrojtje shëndetësore, përveç nëse nuk është përcaktuar më ndryshe me këtë ligj.

(5) Punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor i punësuar në institucionin shëndetësor publik, me pëlqim të tij, mund të merret nga institucioni shëndetësor publik në të cilin është punësuar në KUTSK nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

(6) Punëtori shëndetësor i cili kryen veprimtari specialiste-këshillimore shëndetësore në institucionin shëndetësor privat, si dhe bashkëpunëtori shëndetësor i punësuar në institucionin shëndetësor privat mund të merret në KUTSK nëse për atë janë dakord punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor, drejtori i KUTSK-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Maqedonisë.

(7) Punëtori shëndetësor me arsim të mesëm, të lartë dhe sipëror profesional ose me 180 SETK nga sfera e mjekësisë, i cili kryen veprimtari shëndetësore në institucionin shëndetësor privat, mund të merret në KUTSK, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

(8) Në KUTSK mund të kryejë veprimtari shëndetësore punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor i cili është i punësuar në institucion publik, përkatësisht privat shëndetësor, në pajtim me rregullat nga sfera e marrëdhënieve të punës dhe marrëveshja për punësim (marrëdhënie e dyfishtë pune).

(9) Punëtorët e pensionuar shëndetësorë, përkatësisht bashkëpunëtorët shëndetësorë mund të kryejnë veprimtari shëndetësore në KUTSK në pajtim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim

Neni 21

(1) Në KUTSK mund të punësohet person i cili i përmbush kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta.

(2) Kushtet e veçanta janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,

- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi shëndetësore dhe
- të mos i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) alineja 1 e këtij neni, kur nevojitet avancim i punës përmes bartjes së shkathtësive dhe njohurive nga sfera e mjekësisë dhe/ose histokompatibilitetit dhe imogjenetikës, në KUTSK mund të punësohet edhe punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor me arsim të lartë që është i huaj dhe është profesionit i shquar në sferën e mjekësisë, përkatësisht në sferën e histokompatibilitetit dhe imogjenetikës, me vendim të Qeverisë në bazë të mendimeve pozitive të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në pajtim me rregullat për punësim të të huajve.

(4) Kushtet e veçanta janë:

- të ketë arsim adekuat,
- certifikata për trajnim nga sfera e transplantimit,
- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën dhe
- kushte tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.

Zbatimi i rregullave për të punësuarit në Institucionin shëndetësor publik Klinika universitare për transplantim të organeve dhe indeve dhe sëmundje kirurgjike

Neni 22

Çështjet në lidhje me marrëdhënien e punës së të punësuarve në KUTSK rregullohen me këtë ligj, ndërsa për të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj zbatohen dispozitat e ligjit i cili e rregullon statusin e punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor, dispozitat e ligjit që e rregullon statusin e nëpunësve administrativë, dispozitat e ligjit që e rregullon statusin e të punësuarve në sektorin publik, si dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Rroga mujore, kompensimet dhe shpërblimet

Neni 23

(1) Të punësuarit në KUTSK kanë të drejtë të rrogës, kompensimeve të rrogës dhe shtesave të rrogës dhe kompensimeve të shpenzimeve lidhur me punën nën kushte dhe kritere të përcaktuara me ligj, marrëveshje kolektive dhe marrëveshje për punësim.

(2) Të punësuarit mund të marrin deri në 30% të rrogës bazë si plotësim i rrogës së rregullt gjatë muajit për përgjegjësinë e veçantë e cila del nga vendi i punës që është me rëndësi të veçantë për efikasitetin e KUTSK-së.

(3) Të punësuarit mund të marrin shpërblim në para ose ditë të lira për rezultatet veçanërisht të arritura në punë.

(4) Sistemin e shpërblimit të të punësuarve më afër e përcakton ministri i Shëndetësisë me propozim të drejtorit të KUTSK-së.

Shpërblime dhe mirënjohje

Neni 24

Për punën profesionale shumëvjeçare, avancimin organizues, suksesin në sfera të veçanta të punës në kryerjen e detyrave të punës dhe përmirësimin e autoritetit

të KUTSK-së, të punësuarve në KUTSK u ndahen mirënjohje me shkrim (falënderime me shkrim), si dhe shpërblime në para në pajtim me sistemin e shpërblimit të të punësuarve nga neni 23 paragrafi (4) i këtij ligji.

Puna me ndërresa dhe jashtë orarit

Neni 25

Për nevojat e KUTSK-së, e me urdhër të udhëheqësit të drejtpërdrejtë, të punësuarit mund të punojnë me ndërre dhe jashtë orarit.

Lidhjet e marrëveshjes për dërgim në trajnim

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të KUTSK-së dhe të punësuarit i cili është dërguar në trajnim për nevojat e institucionit, rregullohen me marrëveshje me shkrim në cilën përcaktohet data e saktë deri në të cilën i punësuar nuk mund të kërkojë ndërprerje të marrëdhënies së punës, si dhe përgjegjësia e tij materiale në përpjesëtim me mjetet e shpenzuara për realizim të trajnimit, nëse me fajin e tij ose me kërkesë të tij i ndërpritet marrëdhënia e punës para datës së përcaktuar.

PJESA E PESTË

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do të miratojë vendim për emërimin e ushtruesit të detyrës drejtor i KUTSK-së, i cili është i detyruar t'i bëjë përgatitjet për fillimin e punës së KUTSK-së.

Neni 28

(1) Regjistrimi i KUTSK-së në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë do të bëhet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

(2) Zgjedhja e anëtarëve të organit drejtues të KUTSK-së do të bëhet në afat prej dhjetë ditësh nga dita e regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

(3) Statuti dhe aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të KUTSK-së do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të organit drejtues.

(4) KUTSK-ja do ta marrë numrin e nevojshëm të të punësuarve për kryerjen e veprimtarisë nga institucionet shëndetësore publike ekzistuese me ditën e miratimit të akteve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të KUTSK-së.

(5) Procedura për zgjedhjen e drejtorit të KUTSK-së në pajtim me nenin 12 të këtij ligji do të fillojë të zbatohet në afat prej 10 ditësh nga dita e regjistrimit të KUTSK-së në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR
ORARIN E PUNËS, PUSHIMET E DETYRUESHME TË
PUNËTORËVE MOBILË DHE SHOFERËVE NË
KOMUNIKACIONIN RRUGOR DHE APARATET PËR
REGJISTRIM NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

Neni 1

Në Ligjin për orarin e punës, pushimet e detyrueshme të punëtorëve mobilë dhe shoferëve në komunikacionin rrugor dhe aparatet për regjistrim në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 161/2009, 17/11, 54/11, 115/14 dhe 193/15) në nenin 23 në paragrafin 1 fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Neni 2

Në nenin 24 në paragrafin 6 fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Neni 3

Neni 30 ndryshon si vijon:

"Kartelat memorike nga neni 27 i këtij ligji lëshohen në bazë të kërkesës.

Me kërkesën për lëshimin e kartelës së shoferit parashtruesi i kërkesës dorëzon:

- kopje nga letërnjoftimi,
- kopje nga patenta e shoferit,
- fotografi nga parashtruesi i kërkesës jo më e vjetër se gjashtë muaj,

- vërtetim për qëndrim të përkohshëm ose letërnjoftim për të huaj,

- dëshmi për posedimin e lejes për punë për të huaj dhe

- dëshmi për çmimin e paguar për kartelë për shofer në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

Me kërkesën për lëshimin e kartelës për transportues, parashtruesi i kërkesës dorëzon:

- gjendje rrjedhëse jo më të vjetër se gjashtë muaj për personin juridik të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe

- dëshmi për çmimin paguar për kartelë të transportuesit në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

Me kërkesën për lëshimin e kartelës të punëtorisë, parashtruesi i kërkesës dorëzon:

- gjendje rrjedhëse jo më të vjetër se gjashtë muaj për personin juridik të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë,

- kopje e letërnjoftimit të personit teknik,

- kopje e patentës së shoferit të personit teknik,

- vërtetim për trajnim të përfunduar për aftësim profesional të personit teknik,

- kopje nga autorizimi për punëtori e lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve,

- fotografi nga personi teknik, jo më të vjetër se gjashtë muaj dhe

- dëshmi për çmim të paguar për kartelë të punëtorisë në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

Me kërkesën për lëshimin e kartelës kontrolluese, parashtruesi i kërkesës dorëzon:

- kopje nga letërnjoftimi i personit kontrollues,

- kopje nga autorizimi nga organi kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes,

- fotografi nga personi kontrollues, jo më të vjetër se gjashtë muaj dhe

- dëshmi për çmim të paguar për kartelë kontrolluese në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

Me kërkesën për zëvendësim të kartelës për shkak të dëmtimit ose pamundësisë për bartjen e të dhënave, krahas dokumenteve paraprakisht të theksuara, parashtruesi i kërkesës e dorëzon edhe kartelën e papërdorshme.

Me kërkesën për zëvendësimin e kartelës për shkak të humbjes ose vjedhjes, krahas dokumentet e theksuara, parashtruesi i kërkesës dërgon edhe vërtetim për ç'lajmërim të kartelës në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Emetuesi i kartelës memorike me detyrë zyrtare i mbledh të dhënat e përcaktuara në paragrafin 3 alineja 1 dhe paragrafin 4 alineja 1 i këtij neni. Dëshmitë tjera i siguron parashtruesi i kërkesës.

Për kërkesën për lëshimin e kartelës memorike emetuesi i kartelave vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës së kompletuar.

Nëse emetuesi i kartelave memorike e refuzon kërkesën për lëshim, kundër aktvendimit të emetuesit të kartelave memorike parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të ankesës te Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe mënyrën e lëshimit të kartelave memorike i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve"

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

954.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕВОЗ ВО ПАТНИОТ СООБРАЌАЈ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за превоз во патниот сообраќај, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 22 февруари 2016 година.

Бр. 08-1234/1

22 февруари 2016 година
Скопје

Претседател

на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател

на Собранието на Република
Македонија,

Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКО- НОТ ЗА ПРЕВОЗ ВО ПАТНИОТ СООБРАКАЈ

Член 1

Во Законот за превоз во патниот сообраќај („Службен весник на Република Македонија“ број 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11 и 6/12 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 42/14, 112/14, 166/14, 97/15, 124/15, 129/15 и 193/15), членот 8 се менува и гласи:

„Лиценца од членот 7 став 1 точки 1 и 2 од овој закон може да добие домашно правно или физичко лице (во натамошниот текст: превозник), ако ги исполнува следниве услови:

1. да е впишан во Централниот регистар на Република Македонија и да има регистрирано приоритетна дејност/главна приходна шифра вршење на превоз на патници и стока во патниот сообраќај;

2. да е сопственик на едно или повеќе регистрирани возила за превоз или да има договор за лизинг, што ги исполнуваат посебните техничко-експлоатациони услови пропишани за возила за вршење на одделни видови на превоз во внатрешниот и/или меѓународниот патен сообраќај, при што за меѓуопштински и меѓународен линиски превоз на патници да е сопственик или да има договор за лизинг за најмалку две возила со капацитет од најмалку 22 седишта по возило, за општински линиски превоз на патници да е сопственик на две или повеќе регистрирани возила или да има договор за лизинг за возила со најмалку 8+1 седиште, за линиски превоз на патници во градот Скопје да е сопственик на едно или повеќе регистрирани возила или да има договор за лизинг за возила со најмалку 8+1 седиште, а за слободен превоз и посебен линиски превоз на патници да е сопственик или да има договор за лизинг за најмалку едно возило со капацитет со најмалку 8+1 седиште по возило, што ги исполнуваат посебните техничко-експлоатациони услови пропишани за возила за вршење на одделни видови на превоз;

3. да има вработено во редовен работен однос возачи во зависност од бројот на моторните возила, минимум еден возач по возило (автобуси, товарни возила) што ги исполнуваат условите пропишани со прописите за безбедност на сообраќајот на патиштата;

4. да има вработено авто - такси возачи во зависност од бројот на возила кои ги поседува минимум еден возач по возило, и истите да поседуваат меѓународен сертификат за познавање на англиски јазик на ниво А1 или А2 според Заедничката европска референтна рамка за јазици (CEFR) на Советот на Европа;

5. во возилото со кое се врши авто-такси превоз на патници да има вградено фискален апарат и

6. управителот или овластеното лице одговорно за превоз да има сертификат за професионална компетентност;

7. да има солидна финансиска состојба;

8. да има добар углед;

9. за вршење на меѓународен превоз на патници и стока да има вработено возачи кои имаат сертификат за професионална компетентност на возач за учество во меѓународен превоз на патници и стока.

Лиценца за меѓуопштински линиски превоз на патници и лиценца за меѓународен линиски превоз на патници се издава само на превозници кои поседуваат возила со минимум Еуро 2 еколошки стандард.

Одредбите од ставот 1 точка 6. на овој член не се однесуваат за добивање на лиценца за вршење на авто такси превоз на патници за трговец поединец.

Одредбите од ставот 1 точка 7 на овој член не се однесуваат за добивање на лиценца за вршење на превоз во внатрешниот патен сообраќај.

Одредбите од ставот 1 точки 1 и 7 на овој член не се однесуваат за добивање на лиценца за превоз на патници и стока за сопствени потреби во внатрешниот и меѓународниот патен сообраќај.

Превозникот поднесува барање за добивање на лиценца (нова или продолжување) до Министерството за транспорт и врски или до градоначалникот на општината или до градоначалникот на градот Скопје.

Докажете и податоците за исполнетост на условите од ставот (1) точки 1), 2), 3), 6), 7), 8) и 9) на овој член, ги прибавува овластеното службено лице од Министерството за транспорт и врски кое ја води постапката за издавање лиценца е должно во рок од три дена од денот на приемот на барањето да ги побара доказите од надлежниот јавен орган.

Докажете и податоците за исполнетост на условите од ставот (1) точки 1, 4, 5 и 8. на овој член, ги прибавува овластеното службено лице од општините, односно градот Скопје како надлежен орган за издавање на лиценца за општински превоз на патници и авто такси превоз на патници кое е должно во рок од три дена од денот на приемот на барањето да ги побара доказите од надлежниот јавен орган.

Овластеното службено лице од надлежниот јавен орган е должно бараните докази од ставовите (7) и (8) на овој член да ги достави во рок од три дена од денот на приемот на барањето.

Овластеното службено лице во Министерството за транспорт и врски, општината, односно градот Скопје е должно да одлучи по барањето за лиценца во рок од 30 дена од денот на приемот на барањето.

Доколку превозникот не ги исполнува условите за добивање на лиценцата, Министерството за транспорт и врски односно градоначалникот на општината, односно на градоначалникот на градот Скопје ќе донесе решение со кое барањето ќе биде одбиено.

Против решението на Министерството за транспорт и врски со кое барањето за издавање на лиценца се одбива може да се изјави жалба во рок од осум дена од денот на приемот на решението до Државната комисија за одлучување во управна постапка и постапка од работен однос во втор степен.

Против решението на градоначалникот на општината односно против решението на градоначалникот на градот Скопје со кое барањето за издавање на лиценца се одбива може да се изјави жалба во рок од осум дена од денот на приемот на решението до Министерството за транспорт и врски.

Општините и градот Скопје доколку поседуваат во сопственост возила за превоз на патници со повеќе од 8+1 седиште за вршење на превоз не треба да поседуваат лиценца.

Организација на превоз може да врши и правно лице кое поседува лиценца за организација за превоз, кое во свое име, а за сметка на корисник на превоз склучува договор за превоз со превозник и кое не поседува возила со изводи од лиценца согласно со овој закон. Организатор на превоз не може да учествува на тендери и јавни набавки и истиот не може да биде и носител на договор за превоз на патници или на стока.

Лиценца за организација на превоз на стока во внатрешниот и меѓународниот патен сообраќај може да добие правно или физичко лице кое има регистрирано шифра на дејност, придружни дејности во превозот и кое има запишана главнина и резерви од минимум 100.000 евра во денарска противвредност во билансот на состојба од претходната година и/или запишана главнина за ново трговско друштво, односно гаранција издадена од банка или од осигурателно друштво за обезбедување на финансиска стабилност.

Одредбите од ставовите 1 точки 1, 2, 3, 4, 5, 7 и 10 на овој член не се однесуваат за добивање на лиценца за организација на превоз на стока во внатрешниот и меѓународниот патен сообраќај.

Формата и содржината на барањето од ставот 1 на овој член ги пропишува министерот за транспорт и врски.“

Член 2

Во членот 8-ж ставови 3 и 7 зборот „Министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 3

Во членот 9 став 4 се менува и гласи:

„Превозникот е должен најдоцна 30 дена пред истекот на важноста на лиценцата да поднесе барање за нејзино продолжување до надлежниот орган за нејзино издавање во согласност со одредбите од членот 8 на овој закон. Надлежниот орган при постапувањето по барањето од овој став по службена должност ја проверува веродостојноста на постоечките податоци од евиденцијата за превозникот.“

Член 4

Членот 10 се брише.

Член 5

Во членот 12 став 3 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Во ставот 4 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 6

Во членот 23 став 4 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 7

Членот 24-а се менува и гласи:

„Одобрување на возни редови за нови линии или промена на возни редови на одобрени линии врши Министерството за транспорт и врски по барање на заинтересираните превозници.

За одобрување на возни редови за нови линии или промена на возни редови на одобрени линии, Министерството за транспорт и врски објавува оглас на својата интернет страница и во дневниот печат.

Огласот од ставот 2 на овој член се објавува еднаш во текот на годината и тоа во мај во тековната година.

Постапката за одобрување на возни редови за нови линии или промена на возни редови на одобрени линии се врши по електронски пат.

Право да учествуваат на огласот имаат сите превозници кои имаат лиценца за меѓуопштински или меѓународен превоз на патници.

При електронското барање за одобрување на возни редови за нови линии, односно за промена на возни ре-

дови на одобрени линии, доколку на трасата на линијата за веќе одобрен возен ред, има две заеднички станици, превозникот треба да ги има предвид временските интервали на поаѓање и тоа: за меѓуопштински линиски превоз

должина на линијата во км	минимална временска разлика во минути
	пред/после
0 - 40 км	30
41- 80 км	50
81-120 км	60
преку 120 км	90

При електронското барање за одобрување на возни редови за нови линии, односно за промена на возни редови на одобрени линии, доколку на трасата на линијата за веќе одобрен возен ред има две заеднички станици од кои една на територијата на Република Македонија, а друга на територијата на земјата на пристигнување, и доколку се аплицира за нов меѓународен возен ред, превозникот треба да ги има предвид временските интервали на поаѓање за делот на територијата на Република Македонија, и тоа за меѓународен линиски превоз

должина на линијата во км	минимална временска разлика во минути
	пред/после
0 - 250 км	60
251 - 600 км	180
601 - 1800 км	240
преку 1801 км	360

При електронското барање за одобрување на нов возен ред за меѓународна линија на територијата на Република Македонија доколку линијата е со должина до 250 км превозникот мора да аплицира најмалку 1 станица, доколку линијата е со должина до 600 км превозникот мора да аплицира најмалку 2 станици, доколку линијата е со должина над 601 км превозникот мора да аплицира најмалку 3 станици.

При електронско барање за одобрување на возен ред за нови линии, доколку на трасата на линијата за веќе одобрен возен ред има две заеднички станици, за поаѓање од Велес, Куманово и Тетово кон Скопје во период од 6,00 до 8,00 часот секој ден и за поаѓање од Скопје кон Велес, Куманово и Тетово во периодот од 15,30 и 17,30 часот секој ден, временскиот интервал од едно до друго поаѓање изнесува 10 минути.

При електронското барање за одобрување на возни редови за нови линии, односно за промена на возни редови на одобрени линии превозникот треба да ги има предвид одобрените возни редови објавени на интернет страницата на Министерството за транспорт и врски и одобрените возни редови со спогодба меѓу две општини.

Доколку возниот ред за линијата за меѓуопштински и меѓународен превоз на патници е со повеќе поаѓања кои не можат да се одржуваат со едно возило, превозникот треба за тие возни редови да поседува толку возила колку што е потребно за да може да ги одржува сите поаѓања за кои му се издадени дозволи сметајќи ги и возилата кои му се потребни за одржување на ново одобрените возни редови за превоз на патници.

Превозникот во зависност од остварената добивка за претходната тековна година го има правото да аплицира за меѓуопштински и меѓународен превоз на патници и тоа:

- од 1,000,000 до 2,000,000 денари - најмногу 3 апликации
- од 2,000,001 до 4,000,000 денари - најмногу 5 апликации
- од 4,000,001 до 6,000,000 денари - најмногу 7 апликации и
- над 6,000,001 денари - најмногу 9 апликации

Превозникот кој се стекнал со соодветната лиценца во годината во која се спроведува огласот односно пред законски пропишаниот рок за изработка на завршна сметка има право да аплицира за меѓуопштински и меѓународен превоз на патници онолку апликации колку што поседува возила со извод од лиценца.

Постапката за одобрување на возни редови за нови линии и за промена на возни редови за одобрени линии ја следи и контролира Комисија за одобрување на возни редови за нови линии и за промена на возни редови за одобрени линии (во натамошниот текст: Комисијата) формирана од министерот за транспорт и врски.

Доказите и податоците за исполнетост на условите од ставовите 11 и 12 на овој член, ги прибавува Комисијата која е должна во рок од три дена од денот на аплицирањето да ги побара доказите од надлежниот јавен орган.

Врз основа на добиените резултати од компјутерски обработените барања, Комисијата од ставот 14 на овој член подготвува предлог листа на одобрени, односно одбиени барања и ја доставува до министерот за транспорт и врски на одобрување.

Врз основа на одобрените листи Министерството за транспорт и врски донесува решение со кое возниот ред за линијата се одобрува или барањето се одбива.

Против решението од ставот 17 на овој член може да се изјави жалба во рок од осум дена од денот на приемот на решението до Државната комисија за одлучување во управна постапка и постапка од работен однос во втор степен.

Комисијата од ставот 14 на овој член се состои од пет члена од кои три члена се од Министерството за транспорт и врски и два члена од здруженијата на превозници од патниот сообраќај.

Начинот и поблиските услови за одобрување на возни редови за нови линии и за промена на одобрени линии во меѓуопштинскиот и меѓународниот превоз на патници, издавање, продолжување и одземање на дозволата за одобрена линија, формата и содржината на образецот на дозволата и на возниот ред, ги пропишува министерот за транспорт и врски.“

Член 8

Во членот 28 став 3 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 9

Во членот 30 став 2 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 10

Во членот 32 ставови 1, 2, 3, 4 и 7 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 11

Во членот 44 став 5 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 12

Во членот 57 став 9 по точката се додава втора реченица која гласи: „За новото барање не е задолжително доставување на доказот од ставот 8 на овој член.“

Член 13

Во членот 74 став 3 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 14

Во членот 82 ставови 1, 2, 5 и 6 зборот „Министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 15

Во членот 83 зборот „министерот“ се заменува со зборот „Министерството“.

Член 16

Во членот 87-б став 4 во алинејата 10 сврзникот „или“ се заменува со сврзникот „и“.
Алинејата 11 се брише.

Член 17

По членот 99-ѓ се додава нов член 99-е, кој гласи:

„Член 99-е

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено службено лице во Министерството за транспорт и врски ако не ги побара доказите по службена должност во рокот утврдени во членот 8 став (6) од овој закон.

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено службено лице во општината, односно градот Скопје ако не ги побара доказите по службена должност во рокот утврдени во членот 8 став 7 од овој закон.

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено лице од надлежниот јавен орган од кој се побарани доказите ако не ги достави бараните докази во рокот утврден во членот 8 став 8 од овој закон.

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено лице во Министерството за транспорт и врски, општината, односно градот Скопје, доколку не реши по барањето за лиценца во рокот утврден во членот 8 став 9 од овој закон.

За прекршоците од ставовите 1, 2, 3 и 4 на овој член прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.“

Член 18

Започнатите постапки до денот на започнување на примената на овој закон ќе завршат согласно со законот по кој биле започнати.

Член 19

Одредбите од членовите 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15 и 17 од овој закон ќе започнат да се применуваат со започнувањето на примената на Законот за општа управна постапка согласно со членот 141 од Законот за општа управна постапка („Службен весник на Република Македонија“ број 124/15).

Член 20

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR TRANSPORT NË KOMUNIKACIONIN
RRUGOR

Neni 1

Në Ligjin për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11 dhe 6/12, 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 42/14, 112/14, 166/14, 97/15, 124/15, 129/15 dhe 193/15) neni 8 ndryshohet si vijon:

"Licencë nga neni 7 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji mund të marrë person juridik ose fizik i vendit (në tekstin e mëtejme: transportues), nëse i plotëson këto kushte:

1. të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe të ketë të regjistruar veprimtari/kryesore prioritare, shifër të të hyrave kryerje të transportit të udhëtarëve dhe mallit në komunikacionin rrugor;

2. të jetë pronar i një ose më shumë automjeteve të regjistruara për transport ose të ketë marrëveshje për lizing, që i plotësojnë kushtet e veçanta teknike - të eksploatimit të përcaktuara për automjete për kryerje të llojeve të veçanta të transportit në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe/ose ndërkombëtar, me ç'rast për transport të linjave ndërkomunale ose ndërkombëtare të udhëtarëve të jetë pronar ose të ketë marrëveshje për lizing për së paku dy automjete me kapacitet prej së paku 22 karrige për automjet, për transport të linjave komunale të udhëtarëve të jetë pronar i dy ose më shumë automjeteve të regjistruara ose të ketë marrëveshje për lizing për automjete me së paku 8+1 karrige, për transport të linjave të udhëtarëve në qytetin e Shkupit të jetë pronar i një ose më shumë automjeteve të regjistruara me së paku 8+1 karrige, ndërsa për transport të lirë dhe transport të veçantë të linjave të udhëtarëve të jetë pronar ose të ketë marrëveshje për lizing për së paku një automjet me kapacitet me së paku 8+1 karrige në automjet, i cili i plotëson kushtet e veçanta teknike-të eksploatimit të përcaktuara për automjete për kryerje të llojeve të veçanta të transportit;

3. të ketë të punësuar në marrëdhënie të rregullt të punës përkatësisht shofer në varësi nga numri i automjeteve, minimum një shofer për automjet (autobus, automjet ngarkues) i cili i plotëson kushtet të përcaktuara me rregullat për siguri të komunikacionit në rrugë;

4. të ketë të punësuar auto - taksi shofer në varësi nga numri i automjeteve të cilat i posedon minimum një shofer për automjet, dhe të njëjtat të posedojnë certifikatë ndërkombëtare për njohje të gjuhës angleze në nivel A1 ose A2 sipas Kornizës së përbashkët referente evropiane për gjuhë (CERF) të Këshillit të Evropës;

5. në automjetin me të cilin bëhet transport auto-taksi i udhëtarëve të ketë të vendosur aparat fiskal dhe

6. drejtuesi ose personi i autorizuar përgjegjës për transport të ketë certifikatë për kompetencë profesionale;

7. të ketë gjendje solide financiare;

8. të ketë reputacion të mirë;

9. për kryerje të transporti ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallit të ketë të punësuar shoferë të cilët kanë certifikatë për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transport ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Licencë për transport të linjës ndërkomunale të udhëtarëve dhe licencë për transport të linjave ndërkombëtare të udhëtarëve jepet vetëm për transportues të cilët posedojnë automjete me minimum Euro 2 standard ekologjik.

Dispozitat nga paragrafi 1 pika 6, të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për kryerje të taksi transportit të udhëtarëve për tregtar individual.

Dispozitat nga paragrafi 1 pika 7 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për kryerje të transportit në komunikacionin e brendshëm rrugor.

Dispozitat nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 7 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për transport të udhëtarëve dhe mallit për nevoja personale në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Transportuesi parashtron kërkesë për marrje të licencës (të re ose të vazhduar) te Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ose te kryetari i komunës ose te kryetari i qytetit të Shkupit.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 6), 7), 8) dhe 9) të këtij neni, i grumbullon personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i cili e mban procedurën për dhënie të licencës është e obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafi (1) pika 1, 4, 5 dhe 8 të këtij neni, i grumbullon personi i autorizuar zyrtar nga komuna, përkatësisht komuna e Shkupit si organ kompetent për dhënie të licencës për transportues komunal të udhëtarëve dhe taksi transport të udhëtarëve i cili është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik i cili është i obliguar dëshmitë të kërkuara nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit është i obliguar të vendosë për kërkesën për licencë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Nëse transportuesi nuk i plotëson kushtet për marrje të licencës, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve përkatësisht kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupi do të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa do të jetë e refuzuar.

Kundër aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve me të cilin kërkesa për dhënie të licencës refuzohet mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Komisionit Shtetëror për Vendosije në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve të Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër aktvendimit të kryetarit të komunës përkatësisht kundër aktvendimit të kryetarit të Qytetit të Shkupit me të cilin kërkesa për dhënie të licencës refuzohet mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Komuna dhe qyteti i Shkupit nëse posedon në pronësi automjet për transport të udhëtarëve me më shumë se 8+1 karrige për kryerje të transportit duhet të posedojë licencë.

Organizim të transportit mund të kryejë edhe personi juridik i cili posedon licencë për organizim të transportit, i cili në emër të tij, ndërsa për llogari të shfrytëzuesi të transportit lidh marrëveshje për transport me transportuesin dhe i cili nuk posedon automjet me certifikatë nga licenca në pajtim me këtë ligj. Organizuesi i transportit nuk mund të marrë pjesë në tenderë dhe furnizime publike dhe i njëjti nuk mund të jetë bartës i marrëveshje për transport të udhëtarëve ose të mallit.

Licencë për organizim të transportit të mallit në komunikacion rrugorë të brendshëm ose ndërkombëtar mund të marrë personi juridik ose fizik i cili ka regjistruar shifër të veprimtarisë, veprimtari përcjellëse në transport dhe i cili ka regjistruar kryegjë dhe rezerva nga minimum 100.000 euro në kundërvlerë me denarë në bilenacin e gjendjes nga viti paraprak dhe/ose kryegjë e regjistruar për shoqërinë e re tregtare, përkatësisht garanci të dhënë nga banka ose nga shoqëria tregtare për sigurim të gjendjes financiare.

Dispozitat nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 10 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për organizim të transportit të mallit në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve".

Neni 2

Në nenin 8-zh paragrafët 3 dhe 7 fjala "Ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Neni 3

Në nenin 9 paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

"Transportuesi është i obliguar më së voni 30 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së licencës të parashtrijë kërkesë për vazhdimin e saj te organi kompetent për dhënie të saj në pajtim me dispozitat e nenit 8 të këtij ligji. Organi kompetent gjatë veprimit për kërkesën nga ky paragraf me detyrë zyrtare e kontrollon besueshmërinë e të dhënave ekzistuese nga evidenca për transportuesin".

Neni 4

Nenin 10 shlyhet.

Neni 5

Në nenin 12 paragrafi 3 fjala "ministri" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Në paragrafin 4 fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Neni 6

Në nenin 23 paragrafi 4 fjala "ministri" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Neni 7

Neni 24-a ndryshohet si vijon:

"Lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshimin e rrendeve të vozitjes të linjave të lejuara bën Ministria e Transportit dhe Lidhjeve me kërkesë të transportuesve të interesuar.

Për lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshim të linjave të vozitjes të linjave të lejuara, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve shpall konkurs në internet faqen e saj dhe në shtypin ditor.

Konkursi nga paragrafi 2 i këtij neni shpallet një herë gjatë vitit edhe atë në maj të vitit rrjedhës.

Procedura për lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshimin e rrendeve të vozitjes të linjave të lejuara bëhet në formë elektronike.

Të drejtë të pjesëmarrjes në konkurs kanë të gjithë transportuesit të cilit kanë licencë për transport të udhëtarëve në komunikacionin ndërkomunal dhe ndërkombëtar.

Gjatë kërimit elektronik për lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja, përkatësisht për ndryshim të rrendeve të vozitjes nga linja të lejuara, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes, ka dy stacione të përbashkëta, transportuesi duhet t'i ketë parasysh intervalet kohore të nisjes edhe atë: për transport të linjës ndërkomunale

gjatësia e linjës në km	dallime minimale kohore në minuta
	para/pas
0 - 40 km	30
41 - 80 km	50
81 - 120 km	60
mbi 120 km	90

Gjatë kërimit elektronik për lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja, përkatësisht për ndryshim të rrendeve të vozitjes nga linja të lejuara, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes ka dy stacione të përbashkëta prej të cilave njëra në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa tjetra në territorin e vendit të arritjes, dhe nëse aplikohet për rend të ri ndërkombëtar të vozitjes, transportuesi duhet t'i ketë parasysh intervalet kohore të nisjes për pjesën e territorit të Republikës së Maqedonisë, edhe atë: për transport të linjave ndërkombëtare

gjatësia e linjës në km	dallime minimale kohore në minuta
	para/pas
0 - 250 km	60
251 - 600 km	180
601 - 1800 km	240
mbi 1801 km	360

Gjatë kërimit elektronik për leje të rendit të ri të vozitjes për linjë ndërkombëtare në territorin e Republikës së Maqedonisë nëse linja është me gjatësi deri në 250 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 1 stacion, nëse linja është me gjatësi deri në 600 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 2 stacione, nëse linja është me gjatësi mbi 601 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 3 stacione.

Gjatë kërimit elektronik për lejimi të rendit të vozitjes për linja të reja, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes ka dy stacione të përbashkëta, për nisje nga Velesi, Kumanova dhe Tetova kah Shkupi në periudhën prej 6:00 deri në 8:00 çdo ditë dhe për nisje nga Shkupi në Veles, Kumanovë dhe Tetovë në periudhë prej 15:30 deri në 17:30 çdo ditë, intervali kohor prej njëres deri në nisjen tjetër është 10 minuta.

Gjatë kërimit elektronik për lejimi të rrendeve të vozitjes për linja të reja, përkatësisht për ndryshim të rrendeve të vozitjes të linjave të lejuara transportuesi duhet t'i ketë parasysh rendet e lejuara të vozitjes të shpallura në internet faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe rendet e lejuara të vozitjes me marrëveshje ndërmjet dy komunave.

Nëse rendi i vozitjes për linjën për transport ndërkomunal dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe me më shumë nisje të cilat nuk mund të mbahen me një automjet, transportuesi për ato rende të vozitjes duhet të posedojë aq automjete sa që është e nevojshme për të mundur t'i mbajë të gjitha nisjet për të cilat i është dhënë leje duke i konsideruar edhe automjetet të cilat i janë të nevojshme për mbajtje të rrendeve të reja të lejuara të vozitjes për transport të udhëtarëve.

Transportuesi në varësi nga fitimi i realizuar për vitin rrjedhës paraparak e ka të drejtën të aplikojë për transport ndërkomunal dhe ndërkombëtar të udhëtarëve edhe atë:

- prej 1,000,000 deri në 2,000,000 denarë më së shumti 3 aplikime
- prej 2,000,001 deri në 4,000,000 denarë më së shumti 5 aplikime
- prej 4,000,001 deri në 6,000,000 denarë më së shumti 7 aplikime dhe
- mbi 6,000,001 denarë më së shumti 9 aplikime

Transportuesi i cili është pajisur me licencë adekuate në vitin në të cilin zbatohet konkursi përkatësisht para afatit të përcaktuar me ligj për përpilim të llogarisë përfundimtare ka të drejtë të aplikojë për transport ndërkomunal dhe ndërkombëtar të udhëtarëve aq aplikime sa që posedon leje me certifikatë për licencë.

Procedurën për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja dhe për ndryshimin e rendeve të vozitjes për linja të lejuara e përcjell dhe kontrollon Komisioni për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja dhe për ndryshim të rendeve të vozitjes për linja të lejuara (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i formuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafët 11 dhe 12 të këtij neni, i grumbullon Komisioni i cili është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e aplikimit t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Në bazë të rezultateve të mara nga kërkesat e punuara në kompjuter, Komisioni nga paragrafi 14 i këtij neni përpilon propozim-listë të kërkesave të lejuara, përkatësisht refuzuara dhe e dorëzon te ministri i Transportit dhe Lidhjeve në lejim.

Në bazë të listave të lejuara Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim me të cilin rendi i vozitjes për linjë lejohet ose kërkesa refuzohet.

7) не ги истакне правилата за работа, работното време на скијалиштата и жичарите, цените за користење на уредите, опремата, просторот и услугите на скијалиштето и не се придржува до истите во работењето (член 47 став 1);

8) определи за шеф на патеките лице кое што не ги исполнува условите од членот 48 од овој закон;

9) редарската служба ја извршува лице кое што не ги исполнува условите од членот 49 од овој закон;

10) не ги извести надлежните органи за точниот почеток на сезоната на скијање (член 52 став 1);

11) организира спортска приредба на скијалиштето спротивно на одредбите од членот 54 од овој закон;

12) дозволи пристап до дел од скијалиштето каде што се одржува натпревар на лице коешто не е натпреварувач или службено лице на организаторот (член 55 став 1);

13) организаторот на приредбата не ги отстрани ознаките, уредите, реквизитите и другите предмети поставени поради одржувањето на приредбата (член 55 став 3);

14) обезбедува услуги за подучување на скијање спротивно со членот 57 од овој закон;

15) почетен курс на училиште за скијање се спроведува спротивно со членот 59 ставот 1 од овој закон и

16) инструкторот по скијање не ги исполнува пропишаните услови (член 62);

Глоба во износ од 30% од одмерената глоба за правното лице - скијачки центар односно трговец поединец – скијачки центар ќе му се изрече за прекршоците од ставот 1 на овој член и на одговорното лице во правното лице - скијачкиот центар односно одговорното лице во трговец поединец – скијачки центар.

Член 71

Глоба во износ од 150 до 300 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок на физичко лице - шеф на патеките кој што спротивно на членот 48 ставот 2 од овој закон одобри користење на патеката иако не се исполнети сите услови за нејзино безбедно користење.

Член 72

Глоба во износ од 250 евра во денарска противвредност ќе се изрече на физичко лице ако:

- 1) користи моторни санки спротивно со членот 26 ставовите 2 и 3 од овој закон;
- 2) како водач на група на деца или скијачи почетници не го предупреди редарот за групата или не ги исполни налозите на редарот согласно членот 53 од овој закон и
- 3) работи како инструктор по скијање, а нема лиценца од надлежната спортска федерација (член 57 став 2 и член 62).

Член 73

Глоба во износ од 30 евра во денарска противвредност ќе се изрече на физичко лице ако:

- 1) за време на извршување на редарска служба не носи облека и ознаки кои што јасно го идентификуваат како редар (член 49) и
- 2) како инструктор по скијање за време на подучување не носи ознаки и облека која што јасно го идентификува како лице кое што подучува скијање (член 57 став 3).

Постапка за порамнување со издавање на прекршочен платен налог

Член 74

За прекршоците од член 67, 68, 69, 70 и 71 од овој закон, инспекторот е должен на сторителот на прекршокот да му издаде прекршочен платен налог согласно Законот за прекршоците, пред да поднесе барање за поведување на прекршочна постапка.

По приемот и потпишувањето на прекршочниот платен налог сторителот е должен да ја плати глобата во рок од осум дена.

Сторителот кој ќе ја плати глобата во рокот од ставот 2 на овој член ќе плати половина од изречената глоба, за кое право се поучува во правната поука.

Инспекторот е должен да води евиденција за издадените прекршочни платни налози и за нивниот исход.

Во евиденцијата од ставот 4 на овој член се собираат, обработуваат и чуваат следните податоци: име и презиме, односно назив на сторителот на прекршокот, живеалиште, односно престојувалиште, седиште, вид на прекршокот, број на прекршочниот платен налог кој му се издава и исходот на постапката.

Личните податоци од ставот 5 на овој член се чуваат пет години од денот на внесување во евиденцијата.

Функционерот кој раководи со органот надлежен за работите од областа на спортот ја пропишува формата и содржината на прекршочниот платен налог.

Постапка за порамнување со издавање на мандатен платен налог

Член 75

Кога инспекторот ќе утврди дека е сторен прекршок од член 72 и 73 на овој закон на сторителот на прекршокот ќе му врачи мандатен платен налог согласно Законот за прекршоците.

Ако сторителот доброволно не ја плати глобата во рок од осум дена од врачувањето на мандатниот платен налог, истиот има сила на извршна исправа и инспекторот ќе го достави до органот надлежен за присилно извршување за негово извршување.

Инспекторот е должен да води евиденција за издадените мандатни платни налози и за нивниот исход.

Во евиденцијата од ставот 3 на овој член се собираат, обработуваат и чуваат следните податоци: име и презиме, односно назив на сторителот на прекршокот, живеалиште, односно престојувалиште, седиште, вид на прекршокот, број на прекршочниот платен налог кој му се издава и исходот на постапката,

Личните податоци од ставот 4 на овој член се чуваат пет години од денот на внесување во евиденцијата.

Функционерот кој раководи со органот надлежен за работите од областа на спортот ја пропишува формата и содржината на мандатниот платен налог.

Член 76

За прекршоците утврдени во овој закон, прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

Одмерувањето на висината на глобата за правното лице односно трговецот поединец се врши согласно со Законот за прекршоците.

V. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 77

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Подзаконските акти утврдени во член 74 и 75 од овој закон ќе се донесат најдоцна во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 78

Скијачките центри ќе го усогласат своето работење со одредбите од овој закон во рок од шест месеци од влегувањето во сила на овој закон.

Член 79

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавување во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе отпочне да се применува од 1 јануари 2017 година.

L I G J PËR VENDSKIJIME

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për rregullim, mirëmbajtje, pajisje dhe shfrytëzim të vendskijimeve, të drejtat dhe obligimet e menaxhuesve dhe shfrytëzuesve të vendskijimeve, sigurim të shërbimeve të vendskijimeve, shënim dhe vendosje të sinjalizimit në vendskijimet, shfrytëzim të mjeteve transportuese në vendskijimet, siguri dhe rend në vendskijimet, mësim në vendskijime, si dhe çështje tjera që janë të rëndësishme për shfrytëzimin e vendskijimeve.

Neni 2

Punët nga neni 1 i këtij ligji realizohen në pajtim me këtë ligj dhe ligje tjera të cilat e rregullojnë fushën që ka të bëjë me vendskijimet.

Neni 3

Shprehje të caktuara që janë përdorur në këtë ligj, kanë domethënie në vijim:

1) skijim është rrëshqitje në borë me ndihmën e skive ose me rekuizita të përshtatshme sportive për teknika të ndryshme të skijimit;

2) vendskijim është hapësirë e rregulluar, e shënuar, siguruar dhe nën mbikëqyrje hapësirë për skijim i dedikuar në mënyrë permanente për skijim dhe aktivitete tjera në borë;

3) shteg skijimi i hapur i rregulluar është shteg i përpunuar – e ngjeshur me makinë për rrafshim ose e rregulluar në mënyrë tjetër, me sipërfaqe të shënuara në suazat e vendskijimit që janë dedikuar për forma tjera të skijimit;

4) sipërfaqe tjera skijimi në suazat e vendskijimit me shtigje hyrëse ose dalje deri dhe prej vendskijimit, të cilat i lidhin vendskijimet e ndara dhe shtigjet e skijimit, janë sipërfaqe të dedikuara për ski aktivitete tjera ose veprimtari të sipërfaqeve tjera të rregulluara;

5) hapësirë skijimi e paorganizuar paraqesin sipërfaqet jashtë vendskijimeve, të cilat nuk janë të rregulluara, të siguruara dhe kontrolluara, të cilat qendra sportive nuk i rregullon dhe për të cilat dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen;

6) kalueshmëri e shteg i skijimit është numri më i madh i mundshëm i skitarëve të cilët në interval të caktuar kohor pa pengesa kalojnë nëpër shtegun e skijimit;

7) kapacitet i vendskijimit është numri më i madh i skitarëve të cilët në interval të caktuar kohor gjenden në vendskijimin, duke llogaritur skitarët në shteg, në teleferikët dhe ski-liftet dhe ata që presin për transport në teleferikët dhe ski-liftet;

8) mjete mbrojtëse janë jastëk mbrojtës, rrjete mbrojtëse, rrethoja mbrojtëse dhe pajisje tjetër dhe rekuizita për mbrojtje dhe siguri në vendskijimet;

9) shef i vendskijimit është person i cili i kryen punët për mirëmbajtje të rregullit dhe sigurisë së vendskijimit;

10) shërbime të vendskijimit janë skijime të organizuara dhe aktivitete të specializuara sportive dimërore, mësim për skijim, huazim dhe servisim të pajisjes për skijim, pranim dhe shërbim të skitarëve dhe shfrytëzuesve tjerë të vendskijimit;

11) aktivitete të specializuara sportive dimërore janë rrëshqitje me sajë, bob-rrëshqitje, kërcime, moto-rrëshqitje, lëshim me goma, skijim në borë të thellë, paraglajding, skeleton dhe aktivitete të ngjashme dimërore sportive;

12) skitar është person fizik i cili në qëllime rekreative merret me skijim në vendskijimin, ose gjendet në shteg skijimi me qëllim që të bëjë ski;

13) shteg skijimi është sipërfaqe e rregulluar dhe shënuar në vendskijim, i dedikuar për skijim dhe mësim të skijimit, e furnizuar me një ose më shumë teleferikë dhe e njëjta nuk guxon të prehet me ski-lifte;

14) poligon skijimi është sipërfaqe e vendskijimit e rregulluar dhe e shënuar, i dedikuar për aktivitete të specializuara dimërore sportive;

15) rrugë për skijim është rrugë e krijuar ose e hapur për rrëshqitje me ski që paraqet pjesë të shtegut të skijimit, lidh reciprokisht shtigje për skijim ose lidh shtigje për skijim me objekte tjera në vendskijimin ose shërben për tërheqje (evakuim) të skitarëve të lënduar;

16) zonë mbrojtëse në ski shteg është hapësirë me gjerësi prej 1 – 5 metra (majtas dhe djathtas) që shtrihet deri në shtegun e skijimit;

17) garues është person fizik i inkuadruar në mënyrë aktive në trajnim sistemor të garave të organizuara në shtigjet e skijimit në ski qendrën;

18) rrezik malor është situatë që në vete ngërthen rrezik të madh për personat në vendskijimin (rrezik prej orteku, erozion, rënie në greminë, mbulim me borë që varet në shkëmb të rrëpirët, ngritje ekstreme e shtegut ose pjesës kryesore të shtegut dhe ngjashëm);

19) rrezik i pazakontë dhe i papritur i skijimit është rreziku, përkatësisht rrezikshmëria të cilin skitar mesatar, gjatë vëmendjes së duhur, nuk ka mund të parasheh se do të ekzistojë në llojin e shtegut të cilin e përdor, në kushtet e caktuara kohore, me kusht t'i ketë respektuar rregullat e caktuara me këtë ligj dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji;

20) dukshmëri e zvogëluar ekziston nëse për shkak të kushteve të papërshtatshme atmosferike ose tjera skitari nuk mund qartë t'i shohë persona tjerë të cilët gjenden në vendskijimin në distancë prej së paku 15 metra dhe

21) aksident skijimi është aksident në shteg në të cilin ka marrë pjesë së paku një skitar në lëvizje dhe në të cilin një ose më shumë persona janë lënduar ose kanë humbur jetën ose është shkakuar dëm material.

Neni 4

Vendi i skijimit mund të përdoret për kryerjen e veprimtarive dhe sigurimin e shërbimeve të vendskijimit, me kushte që janë të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit në pajtim me këtë ligj.

Në vendskijimin mund të realizohen skijim alpin dhe nordik, snoubording, biatlon, si dhe mësim për skijim.

Aktivitetet e specializuara dimërore sportive mund të realizohen vetëm në poligone për skijim që duhet të jenë qartë dhe dukshëm të veçuara nga shtigjet për skijim dhe të jenë të shënuara.

Qendra për skijim me vendet për skijim dhe sipërfaqet tjera të rregulluara të dedikuara për skijim dhe aktivitetet e specializuara dimërore sportive menaxhon në pajtim me këtë ligj.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton vendet për skijim, përkatësisht hapësirat e përshtatshme për rregullim të vendeve për skijim, të cilat janë me domethënie të veçantë për zhvillim të aktiviteteve dimërore sportive dhe turizmit malor në Republikën e Maqedonisë, me propozim të organit për punët e sportit.

Akti nga paragrafi 5 i këtij neni përmban edhe vlerësim të arsyeshmërisë për përcaktimin e vendeve për skijim, përkatësisht hapësirave të përshtatshme për rregullimin e vendeve për skijim, sipërfaqeve dhe kufijve, të dhëna për pronësinë, regjistrim të parcelave kadastrale, kurse për zonat me sipërfaqe më të madhe përshkrim detajor të kufijve me paraqitje hartografike në përpjesëtim përkatës.

Neni 5

Rregullimi, pajisja, mirëmbajtja, shfrytëzimi dhe menaxhimi me vendskijimet (në tekstin e mëtejshëm: vendskijim), si dhe menaxhimi me hapësirën e përshtatshme për rregullim të vendskijimeve, në aspekt të këtij ligji konsiderohen për veprimtari me interes publik.

Veprimtaritë nga paragrafi 1 i këtij neni i kryen Qendra për skijim si person juridik ose tregtar individ i formuar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Për përgjegjësinë për dëm të shkaktuar në vendskijim aplikohen rregullat e përgjithshme për përgjegjësi për dëm në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet obligative.

E drejta për kompensim të dëmit të shkaktuar në vendskijim nuk i përfshin dëmet që janë rezultat i rreziqeve të zakonshme dhe rrezikshmërive nga skijimi.

II. RREGULLIMI, SHËNIMI, SHFRYTËZIMI DHE SIGURIA E VENDSKIJIMIT

1. Rregullimi

Neni 7

Vendskijimi përbëhet prej një ose më shumë shtigjeve të skijimit, poligoneve për skijim, shtigjeve për skijim, skilifteve, teleferikëve, rrjetit dhe objekteve infrastrukturore, objekteve të servisit në vend skijimin, mekanizim për borë dhe servisimit, rrugë servitore, objekte energjetike personale, rrugë për hyrje dhe parkingje në hyrjen në vendskijimin dhe objekte për kryerjen e veprimtarive.

Neni 8

Vendskijimi dhe rrugët hyrëse nuk mund të ndërtohen në sipërfaqe të cilat janë, nën reshjet e zakonshme të borës, dhe të ekspozuara në ortekë.

Vendskijimi dhe shtigjet për skijim rregullohen varësisht prej dedikimit dhe llojit të aktiviteteve me qëllim të skitarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në aktivitetet të jenë të sigurt dhe të mbrojtur.

Vendskijimi duhet të jetë i rregulluar që t'i plotësojë standardet ekologjike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe t'i plotësojë kushte sanitare-higjienike të objektit publik.

Neni 9

Shtigjet për skijim doemos duhet të jenë të gjëra, të dukshme, me pjerrësi përkatëse dhe dallim në lartësi dhe të përgatitura në mënyrë që nuk do të ketë gropa në ato, komplekse prej guri ose vende tjera të rrezikshme dhe të kenë pjesë për frenim.

Vendet e rrezikshme në shtigjet për skijim (kthesa, kryqëzime të shtigjeve, pjerrësi më të mëdha, objekte, ku mund të kryhen punë) duhet të jenë veçanërisht të shënuara dhe detyrimisht të siguruara me rrethoja për orientim, rrethoja mbrojtëse ose rrjete, shtresa (jastëkë dhe dyshekë) kundër goditjeve dhe mjete të ngjashme mbrojtëse me lartësi adekuate.

Neni 10

Në shtigjet për skijim dhe zonat mbrojtëse në shtigjet e skijimit nuk lejohet vendosje e reklamave dhe mbishkrimeve të cilat nuk janë të lidhura me shfrytëzimin e shtegut dhe që rrezikojnë sigurinë e vendskijimit.

Neni 11

Shteg skijimi mund të përdoret për skijim vetëm nëse në atë ekziston sasi e mjaftueshme e borës dhe kushte për zhvillim të sigurt të skijimit.

Neni 12

Qendra e skijimit është e obliguar të përcaktojë emërtime për çdo shteg skijimi.

Neni 13

Në shtegun për skijim ndalohet fluturim ose aterim i mjeteve fluturuese, paraglajderëve, delta-planeve, deltaplaneve-motorikë dhe ngjashëm.

Nëse në suazat e vendskijimit është rregulluar hapësirë për fluturim ose aterim, ajo hapësirë duhet qartë të veçohet nga shtegu për skijim, me sinjalizim adekuat dhe i siguruar nga ortekët, në pajtim me dispozitat për aviacion.

Neni 14

Përdorimi i shtigjeve për skijim dhe përmbajtjet tjera të dedikuara për aktivitetet në kushte të natës mund të shfrytëzohet vetëm nëse ka instaluar rrjet adekuat dhe pajisje për ndriçimin e vendskijimit dhe pjesët e hyrjes dhe daljes në atë.

Qendra e skijimit është e obliguar të siguron ndriçim të pandërprerë edhe për rast të ndërprerjes së papritur të energjisë elektrike.

Neni 15

Në suazat e vendskijimit ose në afërsi të drejtpërdrejtë me atë është i detyrueshëm rregullimi i sipërfaqes përkatëse për aterim dhe fluturim të helikopterit, që është e rregulluar, e shënuar dhe e pajisur në pajtim me rregullat ligjore pozitive nga sfera e aviacionit, me qëllim të sigurimit të dhënies së ndihmës së shpejtë.

Neni 16

Shtigjet për skijim me borë artificiale rregullohet me ndërmarrjen e masave shtesë për sigurimin e mbrojtjes së skitarëve, që u përshtaten cilësive të shtigjeve me borë teknike.

Neni 17

Shtegu për skijim që është dedikuar për gara skijimi rregullohet në mënyrë që i plotëson kushtet e veçanta (dallim në lartësi, gjatësi dhe gjerësi të shtegut, trashësinë e shtresës së borës, masa mbrojtëse, përgatitje të shtegut, shënim dhe tjera) të caktuara me rregullat përkatëse ndërkombëtare (FIS) dhe ato nacionale sportive.

Shteg për gara në skijim gjatë kohës së përdorimit në qëllime të skijimit rekreativ, duhet të jetë e rregulluar në mënyrë që i plotëson kushtet e përgjithshme të caktuara me këtë ligj për shënim, sinjalizim dhe ndërmarrje të masave të cilat sigurojnë mbrojtjen e skitarëve.

Vendskijimi që është në pajtim me ligjin i përcaktuar si objekt sportiv në interes për Republikën ka së paku një shteg skijimi të rregulluar në pajtim me rregullat sportive, për gara nacionale dhe ndërkombëtare skijimi.

2. Shënim

Neni 18

Shënimin e vendskijimeve e bën Qendra e skijimit.

Shtigjet për skijim klasifikohen dhe shënohen sipas shkallës së vështirësisë, varësisht nga karakteristikat e zonës, përkatësisht sipërfaqeve nëpër të cilat shtrihet shtegu.

Shtigjet për skijim shënohen me shenja të numëruara (shkopinj) me ngjyra të caktuara:

- 1) shteg i lehtë – ngjyrë e gjelbër;
- 2) shteg mesatarisht i rëndë- ngjyrë e kaltër;
- 3) shteg i rëndë – ngjyrë e kuqe;
- 4) shteg ekstremisht i rëndë – ngjyrë e zezë.

Shtigjet për skijim dhe shtigjet për moto-saja shënohen me ngjyrë të verdhë pavarësisht nga shkalla e vështirësisë.

Shenjat doemos duhet të jenë të vendosura në mënyrë që vazhdimisht do të jenë më të larta se shtresa e borës.

Sipërfaqe të lehta për akses dhe me pjerrësi të butë që shërbejnë ekskluzivisht për mësim të formave themelore të rrëshqitjes me ski nuk duhet medoemos të shënohen me kusht të mos kenë vende të rrezikshme dhe kufijtë e tyre përkatësisht skajet të jenë qartë të dukshme.

Neni 19

Kufijtë e vendskijimit doemos duhet të shënohen në vendet kryesore me shenja të cilat janë të dukshme në kushte të dukshmërisë normale.

Shënimi i kufijve të vendskijimeve bëhet me shkopinje me ngjyrë portokalli dhe me tabelë informimi në të cilën gjendet teksti adekuat.

Neni 20

Në vendskijimin duhet të vendosen tabela panoramike dhe tabela për orientim.

3. Mirëmbajtja

Neni 21

Qendra e skijimit është e obliguar, gjatë tërë kohëzgjatjes së sezonit të skijimit, përkatësisht gjatë gjithë kohës së përdorimit të vendskijimit, ta kontrollojë gjendjen e përgjithshme në vendskijimin dhe ta mirëmbanë në gjendje të duhur, përkatësisht në gjendje e cila mundëson përdorim të dedikuar dhe të sigurt të shtegut.

Gjatë kohës kur vendskijimi nuk është në përdorim, qendra e skijimit është e obliguar të mbanë llogari për ruajtjen e vendskijimit dhe tërëmirëmbajtjen e rregullt të shtigjeve dhe pajisjes në vendskijimin.

Mirëmbajtja e shtigjeve të skijimit përfshin mirëmbajtje gjatë verës dhe dimrit.

Mirëmbajtja e shtigjeve të skijimit, shtigjeve për gara dhe shtigjeve të specializuara bëhet varësisht nga natyra e shtegut, kushtet kohore dhe aktivitetet dimërore sportive që zhvillohen në të njëjtat.

Neni 22

Funksionari i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga fusha e sportit më afërsisht i përcakton kushtet minimale teknike për rregullim, shënim dhe mirëmbajtje të vendskijimit, si dhe rregullat për punë të vendskijimit.

4. Sinjalizimi

Neni 23

Në vendskijimin duhet të vendoset sinjalizim adekuat, në mënyrë që e njëjta nuk do të mund të mënjanohet lehtë dhe të përputhet me rrethanat reale të shtegut.

Neni 24

Sinjalizimi bëhet me vendosjen e shenjave adekuate për ndalesë, obligim, paralajmërim dhe njoftim, tabela plotësuese dhe sinjale me ndriçim.

Shenjat e vendskijimit vendosen dhe mirëmbahen në mënyrë që ato të jenë të dukshme, nuk e pengojnë përdorimin e shtigjeve për skijim dhe skitarët në kohë lehtë të mund të detektojnë dhe të veprojnë në kohë të saktë në pajtim me domethënien e tyre.

Shenjat e vendosura duhet të mënjanohen, plotësohen ose zëvendësohen nëse domethënia e tyre nuk përputhet me kushtet e ndryshuara në vendskijimin ose me kërkesat e sigurisë.

Në vendskijimin nuk guxon të vendosen tabela, drita, shtylla ose objekte tjera të ngjashme me të cilat mbulohet ose reduktohet dukshmëria e shenjave të vendosura ose të cilat me formën, ngjyrën, pamjen e tyre ose vendin e vendosjes imitojnë ose i ngjajnë ndonjë shenje të vendskijimit, ose i verbërojnë skitarët ose tërheqin vëmendjen e tyre në masë që mund të jetë e rrezikshme për sigurinë gjatë skijimit.

Funksionari i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga fusha e sportit më afërsisht i përcakton cilat shenja vendosen në vendskijimet dhe në cilat shtigje, formën dhe përmbajtjen e shenjave dhe vendin e vendosjes së tyre në vendskijimet.

5. Shtigje të pasiguruara

Neni 25

Në shtigje për skijim ilegale, shtigje të pasiguruara dhe jashtë shtigjeve për skijim, skitarët mund të skijojnë në rrezik personal dhe përgjegjësi.

Qendra për skijim, skitarëve në shtigjet e pasiguruara u siguron informata elementare për kohën, rreshjet e borës dhe rreziqet nga mbulimi nga bora.

Në shtigjet ilegale për skijim, qendra e skijimit është e obliguar, në suazat e vendskijimit, të vendosë paralajmërime dhe shenja adekuate.

6. Mjete transportimi të vendskijimit

Neni 26

Në shtigjet për skijim përveç mjeteve motorikë të Qendrës për skijim, nuk mund të ketë asnjë mjet tjetër motorik, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj.

Sajat motorikë përveç sajave motorikë të Qendrës për skijim, mund të shfrytëzohen vetëm në shtigje të specializuara dhe në sipërfaqe që janë posaçërisht të përgatitura dhe të shënuara për shfrytëzim të sajave motorikë.

Drejtuues i sajave motorikë nuk guxon me mjetin të lëviz nëpër shtegun me shpejtësi më të madhe nga shpejtësia e lejuar me shenjën e vendosur për tërë shtegun ose për pjesë të shtegut.

Neni 27

Mekanizimi për rregullim të shtigjeve për skijim përdoret në kohë kur teleferikët dhe ski-liftet nuk funksionojnë.

Nëse përdorimi i mekanizimit për rregullimin e shtigjeve për skijim është i domosdoshëm gjatë kohës së funksionimit të teleferikëve dhe ski-lifteve, qendra e skijimit është e obliguar të ndërmerë masa të veçanta për sigurimin e mbrojtjes së skitarëve.

Çdo mjet i mekanizimit për rregullimin e shtigjeve të skijimit që punon në përgatitjen e shtigjeve të skijimit ose lëviz nëpër vendskijimin duhet të jetë i ngjyrosur me ngjyrë të dukshme që bie në sy dhe e furnizuar me drita përkatëse.

Çdo mjet i mekanizimit për rregullim të shtigjeve për skijim që është i ndaluar në shtegun doemos duhet të sinjalizohet me drita adekuate.

Neni 28

Qendra e skijimit është e obliguar t'i paralajmërojë skitarët në mënyrë adekuate për mundësinë për heqjen e ski-biletës në rast të sjelljes në kundërshtim me këtë ligj dhe me rregullat për punë të vendskijimit.

7. Shfrytëzimi dhe puna e vendskijimeve

Neni 29

Qendra e skijimit mund të kryejë punë në lidhje me shfrytëzimin e vendskijimit me kushtet në vijim:

- 1) ta rregullojë dhe pajis vendskijimin në pajtim me këtë ligj, në mënyrë që do të jetë e sigurt për shfrytëzuesit;
- 2) të sigurojë shërbim për mirëmbajtjen e rendit në vendskijimin dhe të rregullon rendin në vendskijimin (rregulla për rend të vendskijimit);
- 3) të sigurojë shërbim shpëtimi (të trajnuar në mënyrë adekuate me certifikata përkatëse për shpëtim prej teleferikëve, ortekëve, kërkim të skitarëve të humbur dhe ngjashëm);
- 4) të sigurojë dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në vendskijimin;
- 5) të sigurojë sistem të lidhjeve të vendskijimit dhe lidhje me institucionin më të afërt shëndetësor dhe ministrinë e Punëve të Brendshme;
- 6) të sigurojë përcjellje (ditore dhe afatgjatë) të gjendjes së kohës në rajonin ku gjendet vendskijimi (vigjilim meteorologjik);
- 7) të lidh marrëveshje për sigurim të skitarëve dhe shfrytëzuesve tjerë të drejtpërdrejtë në vendskijimet nga pasojat prej aksidentit në vendskijim të mundësorë sigurim të skitarëve me blerje të biletës për skijim;
- 8) të miratojë plan për punë për sezonin e skijimit dhe
- 9) të sigurojë informim përkatës, adekuat, me kohë dhe në vazhdimësi përmes internetit për kushtet aktuale dhe mundësitë për shfrytëzim të vendskijimit.

Neni 30

Qendra e skijimit domos duhet të sigurojë që vendskijimi është i pajisur me:

- 1) numër adekuat të makinave dhe pajisjeve për përgatitje dhe mirëmbajtje të shtigjeve, në proporcionalitet me numrin dhe madhësinë e shtigjeve;
- 2) altoparllant me fuqi të mjaftueshme që të mund të përdoret në mënyrë efikase në vendskijimin dhe
- 3) pajisje sportive dhe tjetër të nevojshme për shfrytëzimin e vendskijimit.

Neni 31

Qendra e skijimit është e obliguar të regjistrohet në evidencën e Federatës së Skitarëve të Maqedonisë.

Evidenca amë nga paragrafi 1 i këtij neni i përfshin të gjitha të dhënat për qendrën e skijimit të caktuara në dispozitat e nenit 4 paragrafi 6 i këtij ligji.

Neni 32

Vendskijimi mund të përdoret edhe për edukim, përsosje sportive në sportet dimërore nga ana e subjekteve juridike, klubeve, federatës, ski shkollave, organeve dhe institucioneve të cilat i plotësojnë kushtet e caktuara me ligj dhe në marrëveshjen me Qendrën e skijimit.

Neni 33

Qendra e skijimit është e obliguar ta njoftojë publikun nëpërmjet mjeteve për informim publik për fillimin dhe fundin e shfrytëzimit të vendskijimit në sezonin aktual të skijimit, si dhe për çdo ndërprerje të punës së vendskijimit që zgjat më gjatë se tre ditë gjatë sezonit të skijimit.

Neni 34

Shfrytëzimi i vendskijimit për ushtrim, gara, trajnim dhe forma tjera të aktiviteteve tjera të skijimit mund të bëhen kur kushtet kohore mundësojnë shfrytëzim të sigurt të shërbimeve të vendskijimit.

Vendskijimi mund të punon natën nëse ekzistojnë kushte teknike dhe kohore dhe nëse është garantuar siguria e skitarëve.

Neni 35

Vendskijimi nuk mund të shfrytëzohet për ushtrim, gara, trajnim, skijim rekreativ dhe forma tjera të aktiviteteve të skijimit në rastet në vijim:

- 1) nëse ka rrezik nga ortekë;
- 2) gjatë kohës së stuhisë me borë, shiut, mjegullës për çka është reduktuar dukshmëria dhe erës që e rrezikon sigurinë e rrëshqitjes, sipas llojit të teleferikut;
- 3) në rast të shtresës së lartë të borës – borë e freskët që nuk është ngjeshur dhe në borë që për shkak të shkrires së shpejtë është zbutur tepër, ose nëse shtegu është i ngrirë;
- 4) nëse në shtigjet nuk ka mjaftueshëm borë;
- 5) nëse aparatet e sigurisë dhe shenjat janë aq të dëmtuara që nuk mund të garantojnë siguri për skitarët ose paraqesin rrezik për ata, si dhe gjatë kohës së punës së makinave për ngjeshjen e borës;
- 6) nëse nuk funksionon sistemi i lidhjeve në vendskijimin dhe
- 7) nëse nuk është siguruar shërbim i kujdestarëve, shërbimi për shpëtim dhe shërbimi për dhënien e ndihmës së shpejtë.

Neni 36

Kur në vendskijimin do të paraqiten rrethanat nga neni 35 i këtij ligji qendra e skijimit është e obliguar të ndërpret punën e vendskijimit ose në pjesë të vendskijimit.

Ndërprerja e punës zgjat derisa zgjasin rrethanat për shkak të të cilave është bërë ndërprerja.

Nëse mbyllja e shtigjeve të skijimit bëhet gjatë ditës, shfrytëzuesi është i obliguar të ndërmerr kontroll të rrëshqitjes për t'u siguruar se skitarët që gjenden në shtegun largohen nga zona e rrezikuar.

Qendra e skijimit është e obliguar t'i publikon, në mënyrë adekuate në hyrjen e vendskijimit, shkaqet për ndërprerjen e përkohshme, përkatësisht ndalesën për shfrytëzimin e vendskijimit.

8. Shërbimi për shpëtim dhe shërbimi për ndihmë të parë

Neni 37

Qendra e skijimit e siguron shërbimin e shpëtimit në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me federatën përkatëse, institucionin apo organizatën që është e trajnuar për sigurimin e ndihmës së parë për të lënduarit përkatësisht skitarët e rrezikuar në shtigjet e skijimit dhe mjetet dhe objektet e vendskijimit.

Në vendskijimin qartë dhe dukshëm duhet të paraqitet selia e shërbimit të shpëtimit.

Neni 38

Shërbimi i shpëtimit duhet të ketë numër adekuat të anëtarëve të angazhuar dhe të jetë i organizuar në mënyrë që gjithmonë është e gatshme për veprim të shpejtë për shpëtim (dhënie të ndihmës së shpejtë dhe transportim të shpejtë) të skitarëve të cilët kanë pësuar aksident në shtegun ose në zonën e mbrojtur.

Neni 39

Masat për shpëtim ndërmerren ekskluzivisht përmes personave të aftësuar profesionalisht (shpëtimtarë), të pajisur në mënyrë adekuate dhe në uniformë.

Shërbimi i shpëtimit detyrimisht ka ekupe të trajnuara për shpëtim të skitarëve nga teleferiku.

Shpëtimtarët gjatë kryerjes së aktiviteteve për shpëtim doemos duhet të kenë përparësi gjatë shfrytëzimit të teleferikëve.

Neni 40

Qendra e skijimit ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve për aksione për shpëtim në lartësi të shpenzimeve reale që janë bërë, përveç nëse nevoja për shpëtim nuk ka ndodhur si rezultat i lëshimit në punën e qendrës për skijim.

Neni 41

Qendra e skijimit vendos shërbim të vetëm shpëtimit për tërë vendskijimin.

Shërbimi i shpëtimit vepron në suazat e vendskijimit.

Nëse në zonën e skijimit ku gjendet vendskijimi nuk funksionon shërbimi malor për shpëtim, qendra e skijimit është e obliguar në kufijtë e zonës së skijimit të organizon shpëtim të skitarëve të cilëve u nevojitet ndihmë edhe pse gjenden jashtë kufijve të vendskijimit.

Qendra e skijimit në rastin e paragrafit 3 të këtij neni, ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve që janë bërë nga personat të cilët u është dhënë ndihmë në lartësi të shpenzimeve reale që janë bërë, përveç nëse nevoja për shpëtim nuk ka ndodhur si rezultat i lëshimit në punën e qendrës për skijim.

Neni 42

Shërbimi i shpëtimit, përkatësisht shpëtimtarët në rast të aksidentit janë të obliguar ta përcaktojnë identitetin e personave të cilët kanë marrë pjesë në aksident dhe të sigurojnë dëshmi në lidhje me shkaktimin e aksidentit, kurse në rast të vdekjes ose lëndimit të rëndë trupor edhe pa prolongim ta njoftojnë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Neni 43

Pajisja dhe mjetet për shpëtim doemos duhet të jenë të sistemuara në atë mënyrë në vendskijimin që të jenë më të arritshme për afat sa më të shkurtër të mundur dhe të jenë të vendosura në hapësirë dukshëm të shënuar.

Qendra e skijimit në vendskijimin duhet të sigurojë pajisje dhe hapësirë për shërbimin e shpëtimit dhe mbajtje të përkohshme të skitarit të lënduar ose të sëmurë papritmas.

Qendra e skijimit është e obliguar në vendskijimin vazhdimisht ta mirëmban pajisjen dhe mjetet për shpëtim në gjendje të rregullt.

Neni 44

Qendra e skijimit e siguron dhënien e ndihmës urgjente mjekësore. Qendra e skijimit e siguron dhënien e ndihmës urgjente mjekësore nëpërmjet angazhimit të personave të aftësuar për dhënien e ndihmës së parë, sigurim të hapësirës përkatëse për pranim të personave të lënduar dhe sigurim të pajisjeve dhe mjeteve për dhënien e ndihmës urgjente mjekësore.

Personat të cilët janë të angazhuar për dhënien e ndihmës urgjente mjekësore, gjatë kohës së kujdestarisë doemos duhet të kenë shenjë përkatëse dhe doemos duhet të jenë të pajisur me aparate për komunikim.

Stafit për ndihmë të shpejtë mjekësore duhet t'i sigurohet përparësi në shfrytëzimin e teleferikut, si dhe përparësi tjera në lidhje me kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Neni 45

Qendra e skijimit është e obliguar të mbajë evidencën për aksidente në vendskijimin (identiteti i viktimave në aksidentin, koha, vendi dhe shkaqet e aksidentit) dhe për ndodhitë e rasteve të aksidentit t'i lajmëron shërbimet kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 46

Pajisjen dhe shënimin për shërbimin e shpëtimit, numrin e shpëtimtarëve dhe mënyrën e aftësimit të tyre nga neni 39 i këtij ligji, si dhe hapësirën e duhur nga neni 44 i këtij ligji i përcakton funksionari i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga fusha e sportit.

9. Siguria dhe rendi në vendskijimin

Neni 47

Qendra e skijimit është e obliguar dukshëm t'i theksojë rregullat për rend në vendskijimin, çmimet për shfrytëzimin e aparateve, pajisjeve, hapësirën dhe shërbimet e vendskijimit, si dhe orarin e punës së vendskijimit dhe teleferikëve si dhe t'i respekton të njëjtat në punën e vet.

Neni 48

Qendra e skijimit është e obliguar të ketë person të punësuar me profesion adekuat sportiv për mbajtjen e llogarisë për sigurinë dhe rendin e vendskijimit (shef i shtigjeve).

Shtigjet e skijimit nuk mund të fillojnë të shfrytëzohen gjatë ditës nëse shefi i shtigjeve nuk ka dhënë leje për këtë, në bazë të vlerësimit se janë plotësuar të gjitha kushtet për shfrytëzim të sigurt të shtigjeve.

Neni 49

Qendra e skijimit është e obliguar gjatë punës së vendskijimit, të sigurojë shërbim të kujdestarëve që duhet të ketë numrin adekuat të kujdestarëve që në mënyrë efektive të siguron shfrytëzim të sigurt të vendskijimit (parrulla, pika kujdestarie dhe tjera), në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat për rend në vendskijimin.

Shërbimin e kujdestarëve mund ta kryen person i cili ka mbaruar së paku arsimin e mesëm.

Numri i kujdestarëve të angazhuar caktohet sipas rrethanave konkrete të vendskijimit, kurse në veçanti sipas intensitetit të pritur të shfrytëzimit të shtigjeve dhe numrit, peshës, madhësisë dhe pamjes së shtigjeve.

Kujdestari është i obliguar gjatë kryerjes së shërbimit të kujdestarit, të mban uniformë dhe shenja të cilat qartë e identifikojnë si kujdestar.

Së paku një prej shërbimit të kujdestarëve doemos duhet të jetë i trajnuar për të përdorur ski dhe saja motorikë.

Funksionari i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga fusha e sportit përcakton mënyrën për marrjen e autorizimit për kryerjen punës së kujdestarit, formën dhe përmbajtjen dhe mënyrën e lëshimit të legjitimacionit të kujdestarit.

Neni 50

Gjatë kryerjes së obligimeve të tij, kujdestari është i autorizuar:

1) përkohësisht ta ndërpresë përdorimin e vendskijimit ose një pjesë të caktuar të tij, në të cilin mban rendin, deri në vendimin përfundimtar të shefit të shtigjeve, nëse ekzistojnë rrethana gjatë të cilave përdorimi i shtegut nuk lejohet;

2) t'i paralajmërojë, respektivisht t'i largojë nga vendskijimi ose nga një pjesë e tij personat të cilët nuk i respektojnë rregullat e përcaktuara me këtë ligj dhe me rregullat për rend në vendskijim dhe

3) t'ia heqë biletën për vozitje me teleferik në mënyrë permanente ose përkohësisht, skitarit ose personit tjetër i cili edhe krahas paralajmërimit nga kujdestari, vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, rrëshqet në tatëpjeta të rrezikuara nga orteku, nuk i respekton shenjat për ndalim dhe udhëzimet, vepron në kundërshtim me urdhrat e shërbimeve të shpëtimit ose përsëri i shkel rregullat e përcaktuara të sjelljes në vendskijim.

Kur skitari ose person tjetër në vendskijimin vepron në kundërshtim me urdhëratë e kujdestarit ose jep rezistencë fizike, për të njëjtën pa prolongim njoftohet Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 51

Skitarët janë të obliguar t'i respektojnë rregullat e vendskijimit dhe udhëzimet dhe vërejtjet që ua japin kujdestarët.

Skitari është i obliguar:

1) në shtegun të sillt në mënyrën e cila nuk i cenon ose lëndon të tjerët;

2) të ngasë me kujdes dhe shpejtësinë dhe mënyrën e ngasjes t'i përshtatë me dituritë e tij dhe kushtet në shteg (rrethinën) dhe pjesën e shtegut, kushtet klimatike dhe reshjet, si dhe me numrin e skiatorëve në shteg;

3) të zgjedhë linjën (drejtimin, orientimin) e ngasjes në mënyrë që të mos i cenojë skiatorët të cilët ngasin para tij dhe të ketë mundësi në kohë të evitohet përplasja me cilin do person ose objekt para tij;

4) t'i parakalojë skiatorët tjerë, qoftë majtas ose djathtas, çdo herë në distancë të atillë e cila u jep hapësirë të mjaftueshme manovrimeve të tyre (lëvizjeve);

5) kur dëshiron të kyçet në ngasje në shteg të caktuar ose kur pas pushimit në shteg, vazhdon të ngasë, në mënyrë të detyrueshme të vërtetohet, duke parë lartë dhe poshtë vetes, se veprimin mund ta bëjë pa rrezikuar veten dhe të tjerët;

6) të mos qëndrojë nëse kjo nuk është e nevojshme (të ndërpresë ngasjen) në pjesë të ngushta dhe pa pamje të mirë të shtegut dhe në rast të rrëzimit, sa është e mundur më parë të lirojë hapësirën;

7) në rastin kur ngjitet, gjegjësisht kthehet nëpër shteg ose kur zbrit në këmbë, për lëvizje ta përdorë ekskluzivisht vetëm skajin e shtegut;

8) t'i respektojë shenjat e vendosura dhe sinjalizimin;

9) në rast fatkeqësie në shteg t'u japë ndihmë të tjerëve;

10) në rast fatkeqësie, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar ose pjesëmarrës, t'i japë të dhënat e tij për identifikim tek shërbimi kompetent i qendrës për skijim (shërbimi i kujdestarëve ose i shpëtimtarëve);

11) t'i respektojë udhëzimet e kujdestarëve;

12) të skijojë me pajisje të rregullt dhe përkatëse, dhe në veçanti të përdorë ski të cilat janë të pajisura me mjete (lidhëse dhe tjera) të cilat mund ta ndalin skinë në rast se ajo ndahet nga skitari;

13) të mos lërë ose të hedhë në shteg sende dhe materiale që mund të pengojnë ose cenojnë sigurinë e skitarëve të tjerë;

14) për skijim në vendskijimin ta përdorë ekskluzivisht shtegun e shënuar, përpos në rast të rrezikut;

15) nëse vendskijimi ndodhet në rajon të mbrojtur në pajtim me ligjin t'i respektojë rregullat të cilat vlejné për shfrytëzimin e rajoneve të mbrojtura të përcaktuara, në pajtim me ligjin, nga personi juridik i cili menaxhon me rajonin e mbrojtur;

16) bërjen e skisë ta përshtatë me kushtet e shtegut kur kushtet e pa volitshme klimatike kanë rritur shkallën e rëndësisë së shtegut dhe

17) detyrimisht të mbajë helmetë mbrojtëse sportive në të gjitha shtigjet për skijim, përveç në ato që janë shënuar si shtigje të lehta-me ngjyrë të gjelbër, e nëse është në moshë deri 14 vjeç.

Skitari nuk guxon:

1) të skijojë në vendskijimin, gjegjësisht në shtegun e cila është shënuar si e mbyllur;

2) të shkatërrojë, mënjanojë, dëmtojë ose në mënyrë tjetër t'i cenojë shenjat e vendosura dhe sinjalizimin në vendskijimin;

3) të skijojë në shtegun nëse është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose ndonjë bari psikoaktiv, gjegjësisht mjet të cilat ndikojnë negativisht mbi aftësitë e tij;

4) të largohet nga vendi i përplasjes me skitar tjetër para se t'ia japë të dhënat për identifikim shërbimit të kujdestarëve, përveç në rastin kur kjo është e nevojshme për shkak të dhënies së ndihmës urgjente mjekësore të lënduarit, në të cilin rast pas dorëzimit të të lënduarit për kujdes mjekësor, do të paraqitet te shërbimi kujdestar më i afërt i qendrës për skijim dhe

5) të vendosë çfarë do lloj shenja ose të lërë çfarë do lloj sende (pa mbikëqyrje) në vendskijimin pa lejen e qendrës për skijim.

Persona me snoubord, persona që garojnë dhe janë pjesëmarrës në disiplina tjera të skijimit janë të obliguar përpos masave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni të ndërmarrin edhe masa tjera përkatëse me natyrën e aktivitetit konkret sportiv dimëror, në pajtim me aktivitetet sportive ndërkombëtare përkatëse (rregullat e FIS).

Neni 52

Para fillimit të sezonit të bërjes ski, qendra për skijim është e obliguar të njoftojë organin kompetent për punë të brendshme për datën e fillimit të sezonit për skijim.

Kur qendra për skijim gjatë sezonit të skijimit pret numër të madh të skitarëve në vendskijimin, duhet në kohë të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të kërkojë ndihmë plotësuese për mbajtjen e rendit në vendin për ski dhe rregullimin e komunikacionit për arritje dhe largim nga vendi për ski.

Neni 53

Udhëheqësi i grupit i cili në vendskijimin çon grup të organizuar të fëmijëve ose skitarëve fillestarë është i obliguar të kujdeset për skijimin e tyre të sigurt. Para fillimit të bërjes ski, në vendskijimin, udhëheqësi i grupit duhet të paralajmërojë kujdestarët për grupin ose fillestarët, të cilëve kujdestarët duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë.

Udhëheqësi i grupit duhet t'i plotësojë urdhrat e kujdestarëve dhe të ndërpresë bërjen ski të grupit ose fillestarëve nëse bërja ski e tyre nuk është e sigurt.

10. Organizimi i shfaqjeve sportive

Neni 54

Në vendskijimin, mund të organizohen shfaqje sportive (gara, përfshirë ushtrime dhe manifestime) në pëlqim të qendrës për ski, nën kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, me ligjin i cili e rregullon sferën e sportit, dispozitat e miratuara në bazë të këtyre ligjeve, rregullat e federatës kompetente për ski dhe Federatës Ndërkombëtare të Skitarëve (FIS).

Organizatori i shfaqjes sportive, gjatë kohës së shfaqjes sportive i ka përpos të drejtat dhe obligimet e përcaktuara për shfaqje sportive me dispozitat të cilat rregullojnë sferën e sportit, rregullat e sportit të federatës sportive kompetente edhe obligimet që janë përcaktuar me këtë ligj për qendrat për skijim, nëse me marrëveshje ndërmjet qendrës për skijim dhe organizatorit nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 55

Në vendskijimin gjegjësisht në pjesën e tij ku mbahet gara ose ushtrimi, gjatë mbajtjes së garës qasje mund të kenë vetëm garuesit dhe personat zyrtarë të organizatorit.

Shtigjet që lejohen për vizitorët doemos duhet të jenë të rregullta, të shënuara qartë dhe të rrethuara me gardhe.

Organizatori i shfaqjes është i obliguar, pas përfundimit të shfaqjes dhe para hapjes së vendskijimit për përdorim të rregullt, t'i mënjanojë shenjat, pajisjet, rekuizitat dhe sendet tjera të vendosura me qëllim të mbajtjes së shfaqjes.

Neni 56

Qendra për skijim është e obliguar të mundësojë shfrytëzimin e vendskijimit për organizimin e garave të skijimit me interes për Republikën, të cilin organi kompetent për punët e sportit e ka përfshirë në programin për aktivitete sportive ndërkombëtare për skijim dhe gjatë kohës së mbajtjes së garës të përshtatë regjimin e punës së vendskijimit me nevojat për kushte sportive.

Shfrytëzimi i vendskijimit nga paragrafi 1 të këtij neni rregullohet me marrëveshje ndërmjet organizatorit të shfaqjes dhe qendrës për skijim.

11. Mësimi i skijimit

Neni 57

Klubi sportiv ose person tjetër juridik i cili ka marrë licencë për shkollë të skijimit në pajtim me Ligjin për sport (në tekstin në vijim: shkollë për skijim), për realizimin e programit për trajnim dhe ushtrim të skitarëve fillestarë ose skitarëve të përparuar, me pëlqim të Qendrës për skijim mund t'i japë shërbimet veta në kushtet si vijon:

1) të jetë i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë për mësim sportiv,

2) të ketë hapësirë përkatëse në vendskijimin dhe vend përkatës për grumbullim të fillestarëve;

3) të ketë lidhur marrëveshje për sigurimin e shfrytëzuesve të shërbimeve për mësim nga pasojat e fatkeqësive dhe

4) të ketë angazhuar persona përkatës për mësim të drejtpërdrejtë.

Me mësimin e drejtpërdrejtë mund të merret vetëm instruktori për skijim me licencë të vlefshme.

Instruktori për skijim gjatë kohës së mësimin doemos duhet të mbajë shenja dhe veshje që qartë ta identifikojë si person që mëson ski.

